

AKT THEMELIMI  
I SHOQERISE TREGETARE  
"LORANSOAL " SHPK

Sot me date 09. 09.2000 ,ne qytetin e Korces , themelohet shoqeria tregetare me ORTAK TE VETEM :

1.- NIKOLLAS KARAQEHALIS,biri i Janit e Sofijes lindur me 1956 e banues ne Strimoniko-Seron,te Greqise,me nr.pas. K 454926, deklroi:

### Neni 1

Shoqeria tregetare "LORANSOAL" SHPK themelohet nga Ortaku i vetem: Nikolas Karaqehalis ne konformitet me ligjin 7638 date 19.II.1992 "Per shoqerite tregetare". Ajo eshte person juridik shqiptar. Selia ndodhet ne Korce, fshati Plase.

### Neni 2

Veprimtaria e shoqense bazohet ne normat e ketij akti themelimi, Statutit te Shoqerise, e legjislacionit shqiptar. Ajo eshte shoqeri me perjegjesi te kufizuar (SHPK). Ortaku mban perjegjesi per detyrimet e shoqerise ne masen e kapitalit te saj.

### Neni 3

Kapitali filletar i shoqerise eshte 100.000 leke dhe i takon terresisht ortakut te vetem. Ai ndodhet i depozituar ne Dhomen e Notereve dhe eshte i regjistruar ne librin e shoqerise ne llogarine e emertuar "Fondi themeltar i ortakeve".

### Neni 4

Objekti i veprimtarise te shoqerise eshte: Veprimtari ne fushen e prodhimeve te robaqepsise, veshje te brendeshme e te jashtme, i te gjitha moshave e sekseve, prodhime ne fushen e qendistarise stampojes, tregetim i prodhimeve te veshjeve, qendisjeve e stamposjeve, tregti me shumice e pakice i artikujve: industriale, ushqimore, bujqesore, blegtore, hidro-sanitare, elektronike, lende drusore, materiale ndertimi, pjesa ndrimi e makineri, veprimtari transporti. Objekti mund te shtohet me vendim te Ortakeve.

### Neni 5

Afati i veprimtarise se shoqerise eshte 15vjet duke filluar nga data e regjistrimit te shoqerise ne regjistrin tregetar. Ai mund te zgjatet me vendim te Asamblese se Ortakave.

## Neni 6

Ortaku i vetem ka te drejte te transferoje kapitalet e shoqerise ne cdo forme qe ai do ta cmoje te arsyeshme. Transferimi i kapitalit behet me akt notarial, ndryshe eshte i pavlefshem.

## Neni 7

Fitimi i realizuar nga shoqeria e pasurite e vena gjate veprimtarise se shoqerise i perkasin terresisht ortakut te vetem. Fitimi eshte lirisht i transferueshem.

## Neni 8

Ortaku i vetem ka detyrim:

- Te regjistroje shoqerine ne regjistrin tregetare e te marre lejen e ushtrimit te profesionit.
- Te derdhe kuotat e kapitalit fillestar.
- Te siguroje mjetet e mjediset ku do te suhtrohet veprimtaria e shoqerise.
- Te siguroje fuqine pughtore te specializuar e te persose kualifikimin e tyre.
- Te krijoje kushtet e nevojeshme per mbrojtjen ne pune te pughtoreve.
- Te derdhe sigurimet e nevojeshme ne organet e Sigurimeve shoqerore.
- Te manazhoje e ekspozoje veprimtarine e tij.


## Neni 9

Organet drejtuese te shoqerise jane:

- Asamblea e Ortakut te vetem
  - Administratori
- Ortaku i vetem mund te caktoje eksperte kontabel.

## Neni 10.

Ortaku i vetem e te punesuarit duhet te ruajne sekretin e themelimit te shoqerise. Te punesuarit per gjigjen per demet qe i shkaktohen me faj shoqerise.



Neni II

Ortaku i vetem nuk ndalohet te marre pjesa ne shoqeri te tjera qofte edhe me te njejtin objekt te veprimtarise.

Neni 12

Mosmareveshjet ose pavlefshmerite e shoqerise zgjidhen ne Gjykaten kompetente. Gjykata kompetente eshte Gjykata e Rrethit Korce.

Neni 13

Akli i themelimit mbasi u lexua nga ortaket u neneshkrua perpara Noterit, pasi e lexozi ne gjuhen greke.

ORTAKU I VETEM  
Nikolaos Karaqealis



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
DHOMA E NOTEREVE KORCE

Nr.Rep.235 Nr.Kol.684

VERTETIM NENESHKRIMI

Sot me date 09.09. 2000 u paraqit perpara meje Ortaku i Vetem NIKOLAOS KARAQEHALIS, per identitetin e te cilit u sigurova me ane te pasaportes,i cili neneshkroi kete akt themelimi.

NOTERI



## S T A T U T

### I SHOQERISE TREGETARE ME ORTAK TE VETEM "LORENZOAL" SHPK

Sot me date 09.09. 2000 ne qytetin e Korcej ORTAKU I VETEM:

1.- NIKOLLAS KARAQEHALIS,biri i Janit e Sofijes lindur me 1956 e banues ne  
Strimoniko-Seron,te Greqise,me nr.pas. K 454926,deklaroi se shoqeria e themeluar  
prej tij do te funksionoje sipas keti Statuti:

## I.- PARIME TE PERGJITHESHME

### Neni 1.- Pozita juridike.

Shoqeria tregetare "LORENZOAL" Shpk, regjillon poziten e saj juridike, mardhnejet midis ortakeve dhe organeve te shoqerise, te punesuarve e personave te trete, kohen e menyren e veprimtarise se saj bazuar ne ligjin 7638 date 19.II.1992 "Per shoqerite tregetare", legjislacionin ne Republiken e Shqiperise, normat e Statutit e Kontrates se Themelimit.

### Neni 2.- Veprimtaria - Selia .

Shoqeria do te zhvilloje veprimtarine ne Republiken e Shqiperise e jashte saj. Selia ndodhet ne Korce, fshati Plase.

Ajo mund te ngreje dege e ajensi edhe ne qytete te tjera .

### Neni 3. - Objekti.

Objekti i veprimtarise te shoqerise eshte: Objekti i veprimtarise te shoqerise eshte: Veprimtari ne fushen e prodhimeve te robaqepsise, veshje te brendeshme e te jashtme, i te gjitha moshave e sekseve, prodhime ne fushen e qendistarise stamposjes, tregetim i prodhimeve te veshjeve, qendisjeve e stamposjeve, tregti me shumice e pakice i artikujve: industriale, ushqimore, bujqesore, blegtoriale, hidrosanitare, elektronike, lende drusore, materiale ndertimi, pjesa ndrimi e makineri, veprimtari transporti.

Objekti mund te shtohet me vendim te Ortakeve

A handwritten signature enclosed in a circle, appearing to begin with the letters 'N' and 'U'.

#### Neni 4.- Emertimi.

Shoqeria do te paraqitet ne qarkullimin civil me emertimin "LORENZOAL"SHPK. Emertimi i shkurtuar i saj do te jetë "LORENZO". Ajo do te kete stemen e saj te miratuar sipas regullave.

#### Neni 5.- Lloji i Shoqerise.

Shoqeria eshte shoqeri me pergjegjesi te kufizuar "SHPK". Ortaku mban pergjegjesi per humbjet deri ne kufirin e kapitalit te investuar prej tij.

#### Neni 6.- Pasurite.

Pasurite e krijuara gjate veprimitarise se shoqerise jane ne pronesi te ortakut te vetem. Ato mund te tjetersohen, te lihen peng ose hipotekohen vetem me miratim te Asamblese se Ortakeve.

#### Neni 7.- Fitimi.

Fitimi i realizuar nga shoqeria u perket terresisht ortakut te vetem. Ai eshte lirisht i disponueshem.

### II . - TE DREJTAT E DETYRAT E ORTAKUT.

#### Neni 8.- Te drejtat e Ortakut .

Ortaku ka keto te drejta qe i realizon nepermjet vendimeve qe mer Asamblea e Ortakeve:

- Administron vlerat ekonomiko financiare e intelektuale te shoqerise.
- Mer pjesa vete ose me ane perfaquesuesi, ne kontrollin e rezultateve ekonomiko financiare.
- Terheq e verifikon dokumentat e shoqerise per tre vjetet e fundit.
- Theret mbledhjen e Asamblese se Ortakeve e caktuje kur eshte rasti rendin e dites.
- Mer nga Administratori i5 dite para mbledhjes materialet e projekt vendimet e saj e Ortakut.

## NENI 9

Ortaku ka keto detyra kryesore:

- Neneshkruan kapitalin themelor te shoqerise.
- Derdh kuotat suplementare ne kushtet e vendosura nga Statuti.
- Ruan sekretin e krijimit te vlerave krijuese e materiale.
- Informon per permiresimin e prodhimit e drejtimit te shoqerise.
- Respekton detyrimet qe burojne nga Kontrata e Themelimit.
- Perpiqet per gjetjen e ritjen e nivelit te specialisteve.

## III .- KUSHTET EKONOMIKE

### Neni 10.- Veprimtaria ekonomike.

Veprimtaria e shoqerise bazohet ne kerkesat e ekonomise se tregut e ka per qellim fitimin. Veprimtaria ekonomike ndertohet mbi parimin e llogarise e pasqyrohet ne bilancet e saj. Llogaria e saj mbahet ne Shqiperi ne monedhe te vendit ose te huaj.

### Neni 11.- Kapitali .

Kapitali fillestari i shoqerise eshte 100.000(njeqint mijë) leke.Ai i perket ortakut te vetem te resisht. Administratori i dorezon ortakut dokumentin vertetues per sasine e kapitalit te depozituar.

### Neni 12.- Pronesia e shoqerise.

Shoqeria behet pronare e pasurise se luajteshme e te paluajteshme qe krijohen nga momenti i themelimit te saj,te cilat i perkasin ortakut te vetem.

### Neni 13.- Heqja dore .

Ortaket mund te heqin dore ne favor te ortakeve te tjere ,bashkeshorit tjeter paraardhesve e pasardhesve .Kur heqja dore behet ne favor te personave te trete,keta jane te detyruar te mos terheqin sasine e kapitalit per 6 muaj, nga data e realizimit te ketij veprimi juridik.



#### Neni 14.- Transferimi i kapitalit.

Kapitali themelor mund te transferohet lirisht tek trashegimtaret ligjore ose testamentare,bashkeshorti me rastin e zgjidhjes se marteses.Ai transferohet edhe tek personat e trete.Personi qe perfiton nga transferimi detyrohet per i vit te mos kerkonte terheqjen e kapitalit.

#### Neni 15.- Menyra e transferimit.

Transferimi i pjeseve te kapitalit themelor vertetohet me akt notarial,ne te kundert eshte i pavlefshem.

#### Neni 16.- Zmadhimi i Kapitalit.

Kapitali themelor mund te zmadhohet kur e kerkojne interesat e shoqerise duke depozituar kuota suplementare sipas vendimit te Asamblese se Ortakeve. Menyra e zmadhimit te kapitalit themelor me para ose ne natyre percaktohet ne ligjin "Per shoqerite tregetare".

#### Neni 17.- Zvogelimi i Kapitalit.

Kapitali themelor mund te zvogelohet me miratim te ortakut te vetem . Kreditoret nuk duhet te demtohen ose te ndjehen te pasigurt nga ky zvogelim,ndryshe shpallet i pavlefshem nga gjykata.

#### Neni 18.- Nxjera e Fitimit.

E ardhura neto qe rezulton mbasi zbriten shpenzimet,amortizimi,pagat,shperblimet taksat e tatimet dhe investimet perben fitimin.,qe i perkset terresisht ortakut te vetem.



Neni 19. - Vleresimi i pasurive.Bilanci.

Pasurite e shoqerise vleresohej ne momentin e krijimit te tyre me monedhe te vendit ose te huaj duke u pasqyruar ne bilancin e saj.Pasurite e vleresuara nuk rivleresohej.Bilanci vjetor paraqitet jo me vone se 31 Marsi i vitit pasardhes.Forma e tij percaktohet nga Administratori ne pajtim me formen e miratuar ne Republiken e Shqiperise.

#### IV. - A D M I N I S T R I M I

Neni 20. - Asamblea e Ortakeve.

Organj i shoqerise eshte Asamblea e Ortakeve. Asamblea vendos me unanimitet per te gjitha problemet qe shqyrton..Per cdo ceshtje qe shqyrtohet ne Asamble mbahet procesverbal i cili qendron gjithmone ne seline e shoqerise.

Neni 21.- Kompetencat.-Delegimi.

Asamblea e Ortakeve shqyrton te gjitha ceshtjet e rendesishme si bilancet vjetore,ndryshimet ne Statut shtimin e pakesimin e kapitalit themelor, EmerimiN shkarkimin e Administratorit,krijimin e filialeve e zyrave e mbylljen e veprimtarise me ane likujdimi.Asamblea mund tu delegoje organeve me te ulta te drejta e detyra te kompetences se saj,te cilat organi vartes duhet ti plotesojo.

Neni 22. - Administratori.

Administrator i shoqerise eshte Z.Nikolaos Karaqehalis ,i cili ka keto kompetencia:

- miraton llogarite ekonomike mbas perpunimit te bere nga administrata.
- pergatit raportin vjetor te veprimtarise se shoqerise dhe e paraqet ne Asamblene e Ortakave.
- paraqet ne Asamble projektin e ndyshimit te kapitalit themelor.
- propozon vendin e kohen e hapjes se zyrave e filialeve.
- propozon ne Asamble ose nxjerr akte lidhur me organizimin e punes.
- propozon eksperte kontabel ose likujdatorin e shoqerise.
- perfaqeson shoqerine ne mosmareveshjet me administraten shteterore,pushtetin shteteror lokal, organet gjyqesore e te tretet.
- lidh kontraten individuale te punes e ate kolektive ,si dhe me te tretet.
- organizon e drejton veprimtarine e shoqerise.
- paraqet raportin e prishjes se shoqerise ne Asamblene e Ortakave.

Administratori zgjidhet cdo dy vjet nga Asamblea.



Neni 23.- Eksperti kontabel.

Ortaku i vetem mund te vendose ekspert kontabel .Ndalohet caktimi si ekspert kontabel i Administratorit e personat qe jane gjini e krushqi deri ne shkalle te katert me te,si dhe perjegjesit e zyrave e filialeve.

V. - MARDHENIET E PUNES.

Neni 24.- Punesimi .

Mardheniet e punes regullohen nga legjislacioni i punes,e dispozitat e Statutit te shoqerise.Punesimi realizohet me ane te kontrates individuale te punes.  
Mardheniet midis shoqerise e Sindikatave regullohen me ane te kontrates kolektive te punes.

Neni 25.- Kontrata e punes.

Kontrata e punes regullon sidomos keto mardhenie:

- kushtet per tu punesuar ne shoqeri.
- lloji i punes qe do te kryhet,profesionet ndihmese.
- koha ditore e javore e punes.Puna e nates ne ditet e festave e pushimit e jashte kohes normale te punes.
- shperblimi i punes dhe per punen jashte kohes normale.
- perjegjesite e paleve per mosrespektimin e kontrates.

VI.- PRISHJA E SHOQERISE - LIKUJDIMI

Neni 26.- Prishja e shoqerise.

Shoqeria prishet me perfundimit e afatit ose te veprimtarise per te cilin u krijua.Ajo mund te prishet para perfundimit te afatit kur:

- Nuk rezulton kontabel per dy vjetet e fundit radhazi.
- Vendos gjykata kompetente.
- Me kerkesen e Ortakut te vetem.



Neni 27.- Likujdimi.

Me prishjen e shoqerise vendoset likujdimi i saj. Asamblea e Ortakeve cakton likujdatorin Gjate likujdimit shoqeria mban anash shenimin "shoqeri ne likujdim e siper".

Neni 28.- Mbyllja e likujdimit.

Likujdimi vendoset nga Asamblea e Ortakeve e cila mblidhet per te kontrolluar, regjistshmenne e likujdimit, bilancin e likujdimit, e heqjen e mandatit te likujdatorit, mbi kerkesen e tij. Mbledhja mund thirret edhe nga ortaku ose te vendoset nga gjykata ne se likujdatori nuk e kerkon.

Me mbylljen e likujdimit e miratimin e tij shoqeria i jep fund veprimtarise. Aktet e mbylljes se likujdimit e llogarite perfundimtare depozitohen ne regjistrin tregetar, duke u cregjistruar shoqeria.

VII. - DISPOZITA TE FUNDIT.

Neni 29 -Pergjegjesite.

Administratori mban pergjegjesi individuale per veprimtarine e tij para Mbledhjes se Ortakeve dhe perjigjet per demet qe i vijne shoqerise nga veprimet e fajshme te tij. Eksberti kontabel perjigjen per demet qe i vijne shoqerise nga mbajtja e gabuar e llogarive ose verifikimi i tyre i gabuar.

Punonjesit e personeli drejtues administrativ mban pergjegjesi civile per demet qe me rai i shkakton shoqerise e pergjegjesi penale kur me dashje shkelin detyrat e ngarkuara.

Neni 30.- Hyrja ne fuqi.

Statuti hyn ne fuqi mbas regjistrimit te shoqerise ne regjistrin tregetar sipas Vendimit te Gjykates se Rrethit Tirane.

Statuti u lexua nga ortaku themelues e u neneshkrua pa vrejtje perpara Noterit, pasi u lexua ne gjuhen greke.

ORTAKU I VETEM  
Nikolaos Karaqehalis

